



Njoftim!

Njoftohen të gjithë studentët e Ciklit të Parë dhe të Dytë të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, se aplikimi për bursa/përrjashtim dhe reduktim të tarifës së shkollimit për vitin akademik 2024-2025 fillon nga data **14.10.2024** deri në datën **01.11.2024**.

Cikli i Parë (Bachelor)

Të gjithë studentët e vitit të parë, të dytë dhe të tretë të Ciklit të Parë, mund të dorëzojnë dokumentat sipas kategorive përkatëse, për të përfituar bursë ose për t'u përjashtuar nga tarifa e shkollimit pranë Departamenteve të Gjuhëve për të cilat studiojnë.

Cikli i Dytë (Master Shkencor apo Profesional)

Të gjithë studentët e vitit të parë dhe të dytë të Ciklit të Dytë, mund të dorëzojnë dokumentat sipas kategorive përkatëse, për të përfituar reduktim të tarifës së shkollimit në masën 50% të saj. Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet pranë Departamenteve të Gjuhëve për të cilat studiojnë.

**STUDENTET E CIKLIT TE PARE BACHELOR DUHET TE HAPIN NUMRIN
E LLOGARISE PRANE RAIFFEISEN BANK DHE TA DOREZOJNE BASHKE
ME DOKUMENTACIONIN PERKATES PRANE DEPARTAMENTIT TE
GJUHES QE STUDIOJNE.**